



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr.014/2021

Nr. Protokolli: 20/2021

<b>Për:</b>	<b>Ekonomik Eko Term SH.P.K.; N.N.SH. TOP PROJEKT ; Lirim Bujari B.I., Brigada 123 pn, 23000, Suhareke</b>
<b>Kopje:</b>	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
<b>Nga:</b>	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b>
<b>Datë:</b>	<b>09.3.2021</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **08.3.2021** të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik Eko Term SH.P.K.; N.N.SH. TOP PROJEKT ; Lirim Bujari B.I., Brigada 123 pn, 23000, Suhareke** me Nr. të Prokurimi: **624-20-5546-5-2-1 & 624-020-104-521** nxjerr këtë:  
nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Apropohet Pjesërsht kërkesa për ri-shqyrtim e datës 08.3.2021 te parashtruar nga Operatori Ekonomik **Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve - Faza e Tretë - Përfundimtare** me Nr. të Prokurimi: **624-20-5546-5-2-1 & 624-020-104-521**.**
- II. Anulohet njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 03.03.2021 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

## Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 08.03.2021 ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik **Ekonomik Eko Term SH.P.K.; N.N.SH. TOP PROJEKT ; Lirim Bujari B.I., Brigada 123 pn, 23000, Suhareke** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve dhe Varrezave të Dëshmorëve - Faza e Tretë - Përfundimtare”** me Nr. të Prokurimit: **624-20-5546-5-2-1 & 624-020-104-521.**

Pas verifikimit të të dhënave në lidhje me pretendimet ankimore të kërkesës për ri-shqyrtim të paraqitura nga ana juaj, ne kemi konstatuar se kërkesa juaj është pjesërisht e bazuar për faktin se oferta e Operatorit Ekonomik ka validitetit edhe për dy muaj tjerë, për këtë jeni në dijeni edhe ju përmes dokumentacionit të kërkuar në qasje nga ana juaj dhe të njejtën dokument e ke të bashkangjitur edhe në kërkesën tuaj për ri-shqyrtim. Ndërsa, sa i përket sigurimit të tenderit, pretendimi juaj qëndron, gjë për të cilën ju falenderojme, kjo për faktin se është një lëshim teknik i lëshuar nga ana jonë edhe pse në kohën e rekomadimin tone për dhënie të kontratës ky sigurim ka qenë valid, dhe do të veprojmë konform dispozitave ligjore për prokurim publik duke e kthyer lëndën në ri-vlerësim.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.  
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit  
Afim BYTYQI

